



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRYEMINISTRIT - UREDI PREMIERJA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nr. orig./ Original No.	02.22
Nr. Prot./ Broj Prot./ Prot. No.	1950
Nr. faqeve/ Br. stranica No. pages	- 05 -
Data/ Datum/ Date	21/09/2011
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

PROKURORIA PUBLIKE E KOSOVËS JAVNO TUŽILAŠTVO KOSOVA	
A	nr.br.no. 500 /2011
Dt. 21.09.2011	
PRISHTINË-PRIŠTINA	

MEMORANDUM BASHKPUNIMI

Ndërmjet

Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike të
Republikës së Kosovës

dhe

Prokurorit të Shtetit

Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike të
Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Kyresuesi i KHAIA

dhe

Prokurori i Shtetit i përfaqësuar nga Kryeprokurori i Shtetit

Janë pajtuar si në vijim:

Neni 1
QËLLIMI

1.Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim ngritjen e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve në kuadër të fushëveprimit dhe kompetencave të përcaktuara me ligj, të cilat paraqesin interes të përbashkët.

Neni 2
Fusha e bashkëpunimit:

- 2.1 Kurdo që inicohet hetim nga prokuroritë e Kosovës për ndonjë incident apo aksident aeronautik, **Prokuroria kompetente që inicon rastin** do të njoftoj KHAIA-n me shkrim.
- 2.2 Në rastet e inicimit të hetimit nga prokuroritë e Kosovës, udhëheqësi i hetimit nga KHAIA, duhet ta dokumentoj trajtimin e çdo prove në vendin e ngjarjes dhe duhet të siguroj që nuk ka ndryshuar asnjë nga provat për nevoja të hetimit.
- 2.3 Në rastet kur inicohet hetim për incident apo aksident aeronautik nga prokuroritë e Kosovës, nëse për nevoja të hetimit inspektorët e KHAIA-s duhet ta modifikojnë ndonjë provë, për ta bërë një gjë të tillë, nevojitet leja parapake nga organi kompetent.

- 2.4 Kurdo që organi i ndjekjës gjatë procesit të mbledhjes së provave, për qëllime të hetimit të rastit ka marrë ndonjë provë nga vendi i ngjarjes, hetuesit e KHAIA-s duhet të kenë qasje të plotë dhe të pa-limituar në prova të tilla.
- 2.5 Kur hetuesit e KHAIA-s kanë nevojë që ta dërgojnë incizuesin e fluturimit apo të dhënave të aeroplanit në një vend të caktuar për lexim, organi kompetent mund të caktoj një person që do të shoqëroj gjithnjë hetuesit e KHAIA-s në punën e tyre për lexim të incizuesit apo regjistruarit të fluturimit.
- 2.6 Kurdo që hetuesit e KHAIA-s, gjatë periudhës së hetimit, dyshojnë se shkaktar i aksidentit apo incidentit është sjellja në kundërshtim me ligjin e ndonjë personi, KHAIA është e obliguar që menjëherë të njoftoj prokurorin kompetent. Informatat e marra nga KHAIA, në raste të tilla, duhet t'i ofrohen menjëherë të plota.

NENI 2 KONTRIBUTI I KHAIA

1. Kurdo që KHAIA kryen ose merr pjesë në një hetim të aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil çdo here do të kujdeset për evidentimin e dëshmive. Në rastet e hetimit edhe nga prokuroritë e Kosovës, KHAIA do të kujdeset edhe për njoftimin e prokurorit lidhur me të gjeturat faktike të rastit.
2. Prokuroria e Shtetit çdo herë që e konsideron të nevojshme do të kërkoj nga KHAIA raport me të gjeturat faktike lidhur me rastet e hetimit të aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil.

3. Gjatë hetimeve KHAIA pranon dëshmi nga dëshmitarët, duke siguruar ata që ato dëshmi do të mbesin konfidenciale dhe nuk do t'i ofrohen prokurorit, përveç nëse janë të detyruar që ta bëjnë këtë për interes të publikut nga gjykata përkatëse.

Neni 3 Kontributi i PSH

1. Prokurori i Shtetit do të përcjellë tek KHAIA informacionet që konsideron që ndërlidhen me hetimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil.
2. Prokurori i Shtetit në raste të caktuara do të ofroj KHAIA-s informacionet që ka në dispozicion, kur kjo kërkohet sipas kërkesës me shkrim të KHAIA drejtuar PSH.
3. Prokurori i Shtetit nëse gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tij ka informacione që i konsideron se janë të rëndësishme dhe në interes për KHAIA të njejtat do të përcillen tek KHAIA pavarësisht se nuk ka pasur kërkesë me shkrim nga KHAIA.

Neni 4 Mënyra e Komunikimit

Bashkpunimi mes PSH dhe KHAIA do të realizohet përmes vijave të sigurta të komunikimit (personave ndërlidhës).

Neni 5 Dispozita e fundit

Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese të memorandumit deri sa palet nuk merren vesh ndryshe.

Palët nënshkruese nuk synojnë që me këtë memorandum mirëkuptimi të krijojnë detyrime ligjore midis njëra tjetrës.

Përpiluar në Prishtinë me 21 shtator 2011, nga dy kopje origjinale për secilën palë nënshkruese, në gjuhën shqipe dhe serbe.

Versioni në gjuhën shqipe dhe serbe duhet të jetë njësoj autentike. Në rast mosmarrveshje, versioni në gjuhën shqipe do të mbizotëroj.

Palët Nënshkruese

PËR KHAIA

Kreshnik Gashi


Kryesues

PËR PROKURORIN E SHTETIT

Ismet Kabashi


Kryeprokurore

